



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology

Numër: 2- 890
Datë: 26.04.2019

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, nenit 17 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në bazë të Rregullores MF- nr. – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, *nxjerr këtë:*

VENDIM

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme të organizatave joqeveritare në këto fusha:

- Mbështetje dhe ofrim për krijimin e kushteve për hulumtime shkencore në fushën e astronomisë;
- Organizimi i programeve edukativo-shkencore të nxënësve /studentëve me shkolla, universitete në shkencën e astronomisë në Kosovë;
- Organizimi i aktiviteteve astronomike me anë të teleskopëve në kuadër të planetariumit dhe observatorit.
- Hulumtimi ose përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkolla ose institucione të arsimit të lartë në fushën e astronomisë;
- Hulumtimet/iniciativa me karakter zhvillimor edukativ apo të përmirësimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në arsim në fushën e astronomisë;
- Aplikimi i inovacioneve astronomike në sferën e mësimdhënies dhe mësimnxënies me shkolla fillore dhe te mesme;
- Krijimi i kushteve për astrofotografimin e trupave qiellor;
- Organizimi i seminareve vjetore me astronom ndërkombëtar.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Kosovës, në kuadër të programit/nënprogramit 98500 Observatori dhe Planetariumi i parë në Kosovë dhe kategorisë ekonomike subvencione dhe transfere.

II

Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshin:
 - 1) Tekstin e thirrjes publike;
 - 2) Udhëzimet për aplikuesit;
 - 3) Formularët e aplikimit;
 - 4) Format për vlerësimin e cilësisë së projekteve;
 - 5) Format për raportimin e zbatimit të projektit.
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 1) Forma e përshkrimit të programit apo projektit;
 - 2) Forma e buxhetit të programit apo projektit;
 - 3) Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta;
 - 4) Deklaratat e partneritetit (nëse është e aplikueshme);
 - 5) Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike;
 - 6) Deklarata për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 1) Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit;
 - 2) Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin;
 - 3) Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit.

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare: <http://masht.rks-gov.net/>

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikues, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.

2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë departamentet e fushave.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm;
2. Arkivit.

